



Ndër të tjera do të lexoni:

- Çfarë është Vettingu?
- Çfarë ndodh me gjyqtarët dhe prokurorët gjatë procesit të vettingut?
- Litigim strategjik kundër diskriminimit të Komunitetit Rom.
- Presumimi i Pafajësisë
- Transparencë dhe ndjeshmëri për kërkesat e minorëve
- KShH vë në lëvizje strukturat shtetërore për furrat gëlqerore
- KShH kërkon rishikimin e dispozitës që detyron gazetarët të tregojnë burimin e informacionit
- Ndihma ekonomike, problem shqetësues

KLINIKA LIGJORE

KONSTATOHET DISKRIMINIM I PACIENTËVE NË SHËRBIMIN E HEMATOLOGJISË NË QSUT

KShH dhe TFL, ju drejtuan Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me rekomandim për të hetuar në rrugë administrative me nismën e tij (ex-officio), diskriminimin e pacientëve në Shërbimin e Hematologjisë pranë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili konstatoi diskriminimin e drejtpërdrejtë të shtetases G. D., dhe të gjithë pacientëve të Shërbimit të Hematologjisë për shkak të gjendjes shëndetësore. Gjithashtu, Komisioneri ka urdhëruar që kjo Qendër, të sigurojë në kohë dhe në sasi, medikamentet mjekësore që nevojiten në Shërbimin e Hematologjisë. Për më shumë informacion lexoni: [ARTIKULL](#)

GJYQËSORI

Vetting

ÇFARË NDODH ME GJYQTARËT DHE PROKURORËT QË DORËHIQEN GJATË PROCESIT?



Para se të nisnin të parat seanca dëgjimore pranë KPK-së, në media janë publikuar dy raste të dorëheqjes nga funksioni, përkatësisht nga një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe ish Prokurori i Përgjithshëm, të cilët bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve që kanë përparësi në procesin e vettingut. Pyetja që lind natyrshëm dhe ka interes për publikun është, çfarë ndodh me gjyqtarët dhe prokurorët që dorëhiqen gjatë procedurës administrative (veçanërisht në kohën mes përfundimit të hetimit administrativ dhe para seancave dëgjimore)? Për më shumë informacion lexoni: [ARTIKULL](#)

PREZUMIMI I PAFAJËSISË - PARIM I RËNDËSISHËM KUSHTETUES

Në konferenca shtypi dhe në deklarata publike nuk janë të pakta rastet ku bëhen akuza penale nga më të ndryshmet dhe nga më të rëndat, madje formulohet edhe përmbajtja e tyre. Nëse është kështu, përse nuk zbatohet legjislacioni penal që parashikon detyrimin për të bërë denoncimin në organet përkatëse, duke paraqitur edhe materialet “e padiskutueshme” që pretendohet se i disponojnë. Për më shumë informacion lexoni: [ARTIKULL](#)

DY ORGANET NDIHMËSE TË VETTINGUT DETYROHEN TË BËJNË TRANSPARENCË TË PLOTË PAS ANKIMIT TË KSHH-SË



Komiteti Shqiptar i Helsinikit (KShH) fiton betejën e parë në kuadër të transparencës së kërkuar për publikun për procesin e Vettingut. Pas ankimit tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit (Komisioneri), KShH-së i është pranuar ankimi ndaj dy organeve ndihmëse të vettingut, përkatësisht ndaj Për më shumë informacion lexoni: [ARTIKULL](#)

Çfarë është Vettingu?

Vettingu ose rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve konsiderohet një masë e jashtëzakonshme për reformimin e organeve të drejtësisë dhe pastrimin e tyre nga njerëzit e drejtësisë që janë të korruptuar, me lidhje me krimin e organizuar ose të paafët profesionalisht. Ky vlerësim, do të përfshijë të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, këshilltarët ligjorë pranë gjykatës kushtetuese dhe gjykatës së lartë etj.

Vlerësimi do të bëhet në bazë të disa kriterëve, siç janë vlerësimi i pasurive, kontrolli i figurës, kontaktet e papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

Ky vlerësim, do të bëhet nga komisioni i pavarur, por personat që do të nënshtrohen këtij vlerësimi kanë të drejtë të ankohen në kolegjin e apelimit pranë gjykatës kushtetuese.

GRUPET VULNERABËL



KËRKESAT E MINATORËVE TË SHQYRTOHEN ME TRANSPARENCË DHE

KShH i bën thirrje organeve përkatëse shtetërore që ti japin përparësi shqyrtimit të kërkesave të minatorëve, me synim zgjidhjen e tyre edhe nëse do të nevojiteshin ndryshime në legjislacionin në fuqi. Për më shumë lexoni: [ARTIKULL](#)

NDIHMA EKONOMIKE, PROBLEM SHQETËSUES

KShH mendon se shteti duhet të tregojë më tepër kujdes për shtresat në nevojë që nuk kanë të ardhura dhe që nuk plotësojnë as kushtet minimale të jetesës, që janë të paaftë për punë ose nuk mund të punësohen në kushte të përshtatshme, siç parashikojnë objektivat sociale të renditura në nenin 59, të Kushtetutës. Për më shumë lexoni: [ARTIKULL](#)

LITIGIM STRATEGJIK KUNDËR DISKRIMINIMIT TË ANËTARËVE TË KOMUNITETIT

KShH, në bashkëpunim me avokatët e European Roma Rights Center, në dt. 16 Janar 2018, iu drejtua Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me Kërkesë-padi për konstatimin e diskriminimit në formën e “Shqetësimit” dhe “Diskriminimit të tërthortë” ndaj 5 Paditësve që i përkasin Komunitetit Rom në Bashkinë Tiranë, të cilët sigurojnë jetesën duke mbledhur dhe shitur materiale të riciklueshme.

Për më shumë informacion lexoni:

TRAJTIM ÇNJERËZOR NË BURGUN E ZAHARISË (KRUIJË) I TË SËMURËVE MENDORË ME MJEKIM TË DETYRUAR

Nga monitorimi rezultoi se në këtë institucion, veç të tjerëve ndodhen 143 persona me mjekim të detyruar, të cilët ishin vendosur në seksion të veçantë, në dhoma ku u vërejt mbipopullim tepër shqetësues deri në 12 persona. Dhomat ishin në kushte tepër të vështira që ndikonin në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të këtyre personave. Konkretisht u vërejt Për më shumë lexoni: [ARTIKULL](#)

MIRËQEVERISJA

KSHH VË NË LËVIZJE STRUKTURAT SHTETËRORE PËR TI DHËNË FUND NDOTJES NGA FURRAT GËLQERORE


Gjetjet shqetësuese dhe rekomandimet në studimin e pandëshkueshmërisë për veprimtarinë e furrave gëlqerore realizuar nga KShH, janë pasuar me një reagim të menjëhershëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Vetëm një javë pasi Komiteti i përcolli konkluzionet e studimit në këtë ministri dhe në një sërë institucioneesh të linjës dhe organin e akuzës, nisi aksioni për mbylljen e furrave gëlqerore në Krujë.

Por çfarë vuri re Komiteti i Helsinkit në këtë studim? Për më shumë lexoni: [ARTIKULL](#)



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT KËRKON RISHIKIMIN E DISPOZITËS QË DETYRON GAZETARËT TË TREGOJNË BURIMIN E INFORMACIONIT

KShH vëren se formulimi i pikës 3 të nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale detyron gazetarin të identifikojë burimin e informacionit, në çdo rast që gjykata do ta vlerësojë këtë, pavarësisht nëse jemi ose jo në rrethanat kufizuese të parashikuara në nenin 10 të KEDNJ-së, siç janë integriteti territorial, sigurimi publik, sigurimi kombëtar etj. Formulimi i nenit 159 pika 3 e K.Pr.P mund të krijojë hapësira për interpretim të gjerë dhe subjektiv, me pasoja cenimin e lirisë së medias. Për më shumë lexoni: [ARTIKULL](#)



EDUKIM LIGJOR

MBYLLET CIKLI I TRAJNIMEVE TË RRJETIT TË AVOKATËVE


Komiteti Shqiptar i Helsinkit në periudhën qershor 2017 - mars 2018 zbatoi nismën “Së bashku me avokatët e rinj, të përkushtuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për të luftuar rastet e mashtrimit dhe korrupsionit”, i cili u mbështet financiarisht nga Ambasada Britanike në vendin tonë. Në kuadër të kësaj nisme, KShH ngriti dhe trajnoi një rrjet avokatësh të rinj. Për më shumë lexoni: [ARTIKULL](#)

KLINIKA LIGJORE

ANALIZA E ANKESAVE TË ARDHURA PRANË KSHH-SË

Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2018 KShH-së i janë adresuar 96 raste ankesash nga qytetarë të ndryshëm. Ankesat trajtohen nga Klinika Ligjore falas, ato ndiqen administrativisht dhe/ose gjyqësisht sipas rastit. Ankesat pranë KShH janë paraqitur më së shumti me anë të telefonit rreth 70% e ankesave, pjesa dërrmuese e të cilave janë adresuar nga persona të privuar nga liria. Rreth 19% e totalit të ankesave përbëjnë pretendimet për shkelje të të drejtave të individit nga veprimtaria e sistemit të drejtësisë, veçanërisht të gjykatave shqiptare

Klinika Ligjore ka ofruar këshillim ligjor, në masën rreth 36% të shërbimeve ndaj ankuesve. Formë tjetër e shërbimit të ofruar është edhe ndërhyrja institucionale, në 9% të numrit total të ankesave, nga të cilat, organet kompetente kanë në rreth 70% të rasteve në fjalë. Rreth 3% e ankesave kanë rezultuar shqetësuese dhe janë bërë objekt për monitorim dhe verifikimin e situatës.



Përsa i përket shtrirjes gjeografike të vendbanimit apo vendqëndrimit të ankuesve, përqëndrimi më i madh i përket qarqeve si Elbasani (qyteti i Peqini, rreth 19% e rasteve), Tirana (rreth 17 % e rasteve), Qarku i Durrësit (Fushë Kruja me rreth 16% të rasteve) etj.

Bazuar në faktin e ankesave të shumta në fushën penitenciare dhe atë gjyqësore, rezultojnë se **neni 13** (rreth 21% e rasteve), **neni 3** (rreth 10%), **neni 8** (rreth 14%) dhe **neni 6** (rreth 19%) i KEDNj-së janë më të çenuar në raport me totalin e ankesave

SHËRBYMET E OFRUARA NGA KSHH

KËSHILLIM LIGJOR

MONITORIMI I RASTEVE

NDËRHYRJE INSTITUCIONALE

PËRFAQËSIM GJYQËSOR



Rreth 89% e ankesave vijnë nga shtetas të gjinisë mashkullore dhe rreth 11% e ankesave kanë ardhur nga shtetase femra. Pothuajse të gjitha ankesat e adresuara vijnë nga shtetas të rritur.

GRANTE

Në 20 janar 2017, KShH filloi implementimin e projektit “Shoqëria Civile Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” në partneritet me Komitetin Norvegjez të Helsinkit, Komitetit Hoalndez të Helsinkit, Komitetit Serb të Helsinkit dhe Together for Life dhe me mbështetjen financiare të Komisionit Evropian. Në kuadër të këtij projekti, KShH publikoi një thirrje të hapur për aplikime për projekt propozime. Pas procesit të përzgjedhjes së 20 organizatave fituese, në 11 janar 2018 organizatat fituese filluan zbatimin e projekt propozimeve. Përmes zbatimit të kësaj iniciative ne synojmë:

- ⇒ synojmë të përforcojmë kapacitetet profesionale të organizatave të shoqërisë civile në zonat lokale, të sigurojmë arsimimin e të drejtave të njeriut në sektorin formal të arsimit dhe universiteteve dhe të ndihmojmë sistemin e burgjeve në sigurimin e masave efektive dhe të ndjeshme të të drejtave të njeriut për të parandaluar radikalizimin dhe rekrutimin e ekstremistëve të dhunshëm;
- ⇒ Po e përqendrojmë punën tonë me OJF-të rinore, gratë, organizatat fetare, kulturore dhe ekonomike sidomos në zonat e largëta të vendit, si dhe po ndërveprojmë për të përfshijë studentë dhe nxënës të shkollave të mesme nga disa qytete shqiptare dhe së fundi, po punojnë me punonjësit e sistemit të burgjeve, për të ndërtuar masa mbrojtëse që theksojnë vëzhgimin e të drejtave të njeriut ndërkombëtare dhe kombëtare.
- ⇒ 3) në të njëjtën kohë po punojmë krah për krah me organizatat lokale për t'i udhëhequr ata për të zhvilluar iniciativa të mira dhe për t'i trajnuar ata gjatë zbatimit të projekteve të përgjithshme dhe me institucionet publike të përfshira, duke siguruar përfshirjen e tyre të plotë.

Ky buletin është përgatitur në kuadër të projektit “Përmirësimi i situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika ligjore XII”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga organizata Civil Rights Defenders, me fonde të Qeverisë së Mbretërisë Suedeze.



Suedi
Sverige



Përmbajtja e këtij bulletini është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Qeverisë Suedeze ose të organizatës Civil Rights Defenders.

Gjetjet dhe çështjet e publikuara në këtë buletin u mundësuan nga: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Ambasada e SHBA-ve në Shqipëri, Civil Rights Defenders, Komisioni Evropian, Open Society Institute - Budapest, Ambasada e Vendeve të Ulëta në Shqipëri, Ambasada e Britanisë së Madhe, ERRC European Roma Right Community, Komiteti Holandez i Helsinkit, Bank Eatch etj.